



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.03.2022)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:35 dhe mbaroi në orën 14:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Irena Plaku (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ridvan Hado (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtare)*
- 10. Marçela Shehu (anëtare)*
- 11. Yllka Rupa (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.

7. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi:

1.1 “Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”;

1.2 “Për ricaktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 28.03.2022.

Siç jeni në dijeni, sot në rendin e ditës janë dy çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}.

Çështja e dytë ka të bëjë me ricaktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Sot Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar dy projektvendime, bashkëlidhur edhe relacionet përkatëse, që i referohen çështjes në lidhje me zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren {...}, është gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, aktualisht e përfshirë në skemë delegimi dhe vijon të ushtrojë funksionet pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Relacioni i parë që unë dua ta prezantoj përpara jush ka për objekt zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}.

Me datë 19.03.2021, gjyqtarja {...} ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Mbi këtë kërkesë, pasi konstatoi se gjyqtarja znj.{...} plotësonte kriteret për komandimin/caktimin në skemën e delegimit të ngritur pranë tij, sipas nenit 45 i Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, si dhe vendimit të tij nr. 22 datë 07.02.2019, “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 104, datë 25.03.2021, ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj.{...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj.{...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave. ...”.

Si gjyqtare e skemës së delegimit, për shkak të situatës në Gjykatën e Apelit Korçë dhe nevojave emergjente të saj në lidhje me funksionalitetin, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 105, datë 25.03.2021, znj.{...} e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për të gjithë periudhën e caktimit/komandimit në skemën e delegimit, deri më datë 25.03.2022.

Afati i komandimit/caktimit në skemën e delegimit të gjyqtares {...}, ka përfunduar më datë 25.03.2022, ndaj, bazuar edhe në kërkesën e vetë gjyqtares, protokolluar në Këshill me nr. 1817 prot., datë 25.03.2022, me anë të cilës kërkohet zgjatjen e afatit të komandimit si gjyqtare, pranë Gjykatës së Apelit Korçë, vlerësojmë se është rasti për zgjatjen e këtij afati.

Aktualisht sistemi gjyqësor është në një situatë vështirë për burime njerëzore, specifikisht për gjyqtarë. Më datë 25.03.2022, në raport me organikat e të gjitha gjykatave (408 gjyqtarë gjithsej), organikën në fakt të gjykatave (325 gjyqtarë), dhe duke pasur parasysh faktin se efektivisht në detyrë janë vetëm 220 gjyqtarë, rezulton se në sistem mungojnë 188 gjyqtarë ose përafërsisht 46,07 % e tyre.

Situata agravohet po t’i referohemi specifikisht gjykatave të apeleve, në të cilat, më datë 25.03.2022, mungojnë 59 gjyqtarë (nga 102 gjithsej sipas organikave të gjykatave në sistemin e Republikës së Shqipërisë) ose 57,84 % e tyre.

Në gjykatat e apelit siç thamë situata është e vështirë, pasi në to kemi mungesë të numrit të gjyqtarëve që unë përmenda më lart.

Ndodhur në një situatë të tillë, ndërsa më herët është verifikuar plotësimi nga znj. {...} të kriterëve të skemës së delegimit, duke mbajtur në konsideratë se ajo ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit, sikundër dhe faktin se ligji lejon shërbimin në këtë skemë deri në 5 vjet (pika 2, neni 45, i Ligjit nr. 96/2016), ndërkohë që

znj. {...} ka konsumuar vetëm një vit nga kjo periudhë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se është vendi për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarës znj.{...} edhe për një vit tjetër, ndërsa në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshilli ka detyrimin për të plotësuar, për sa është e mundur, vakancat në sistem, aktualisht, në veçanti, ato në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat paraqesin problematika të rënda në lidhje me funksionalitetin e tyre. Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarës znj.{...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimi bën fjalë për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarës znj.{...} deri më datë 25.03.2023, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 25.03.2022, pra ditën që përfundon afati i parë i caktimit të saj në skemë delegimi.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet znj.{...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ajo ka caktimin e përhershëm.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju falënderoj për vëmendjen.

Nëse jeni dakord, mund të vijojmë më tej?

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të parë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...} deri më datë 25.03.2023, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 25.03.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë i cili ka të bëjë me ricaktimin e gjyqtarës në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë. Jemi dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me projektvendimin e dytë.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 25.03.2023.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 25.03.2022.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Korçë.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor